

POLITIKA E PRIVATESISE

Savatours Sh.p.k. (më poshtë referuar shkurtimisht **Savatours**) është një operator i Shërbimeve Turistike në kuptim të Ligjit nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e Konsumatorëve" i ndryshuar, të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, Opinioni i Komisionerit Mbi Mbrojtjen e të dhënave në faqet e Internetit të Kontrolluesve Publikë dhe Privat, Savatours ushtron veprimtarinë e vet sipas Politikave të mëposhtme me qëllim përmbushjen e nevojave të sotme dhe të ardhme të klientëve të saj.

Savatours e konsideron mbrojtjen e privatësisë dhe të të dhënave personale të klientëve si çështje të një rëndësie të veçantë. Për këtë arsye Savatours është e përkushtuar të zbatojë me përpikmëri të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale¹.

Duke u mbështetur në legjisllacionin në fuqi, Savatours ka hartuar dhe zbaton këto Politika të Privatesise ("**Politika**") për të informuar këdo në lidhje me trajtimin e të dhënave personale nga ana e Savatours.

Këto Politika përbëjnë një akt të detyrueshëm për administratorin, punonjësit e Savatours si dhe për marrëdhëniet e Savatours me partnerët e saj turistik ose joturistik.

Politika paraqet në mënyrë shumë funksionale të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe klientëve në kuadrin e plotësisht të detyrës së tyre për shërbimet e ofruara nga Savatours.

Të Dhënat personale dhe Përpunimi i tyre

Të dhënat personale janë çdo informacion për një person fizik, i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm.

Përpunimi i të dhënave personale është çdo veprim që kryhet plotësisht ose jo me mjete automatike, me të dhënat personale, si grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, ndreqja, këshillimi, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi apo çfarëdo veprim tjetër, si dhe transmetimi i të dhënave.

Çfarë të dhënash përpunon Savatours

Të Dhëna Personale

Savatours do të marrë nga klientët e saj të dhënat e nevojshme për përmbushjen e aktivitetit të saj si: emër mbiemër, numër telefoni fiks/numër mobil dhe adresë emaili.

Përpunimi i të Dhënave Personale dhe Informimi

¹ Kushtetuta e Shqipërisë, nenet 35 dhe 36; Ligji Nr 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar; Ligji nr. 93/2015 "Për Turizmin", si dhe aktet e tjera nënligjore në plotësim dhe zbatim të tyre.

Savatours mund të përpunojë të dhënat personale sa më sipër në përputhje me nenin 6 të Ligjit nr. 9887, date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, (“**Ligji 9887**”) vetëm pas pranimit paraprak nga ana e klientit, për qëllime të ofrimit të shërbimit turistik si dhe statistikave të brendshme lidhur me ofrimin e shërbimeve turistike që përbëjnë objektin të veprimtarisë së saj.

Savatours informon klientët për llojin e të dhënave që përpunohen, para se të japin miratimin për përpunimin e tyre. Klientet dhe përdoruesit kanë të drejtën të tërhiqen në çdo kohë nga miratimi që kanë bërë.

Savatours do të ruajë dhe përpunojë të dhënat personale të nevojshme për shërbimin e rezervimeve, faturimit dhe të ofrimit të shërbimit turistik sipas kërkesës tuaj. Mënyra e ruajtjes, kohëzgjatja, mënyrën e përpunimit të të dhënave të trafikut janë të përcaktuara në Rregulloren për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të dhënave personale.

Të dhënat personale përpunohen vetëm nga personat përgjegjës, të autorizuar nga Savatours, të cilët janë përgjegjës për faturimin dhe shërbimin me klientin, ndërkohë që përpunimi, detyrimisht, duhet të kufizohet vetëm për zhvillimin e veprimtarisë së Savatours.

Llojet e të dhënave që përpunohen nga Savatours janë: Të dhënat e dhëna *vullnetarisht* nga Klienti e pikërisht emër mbiemër, numër telefoni fiks/numër mobil dhe adresë emaili.

Savatours nuk përpunon të dhëna sensitive të përcaktuara në bazë të nenit 3 të Ligjit 9887.

Qëllimi i Përpunimit të të Dhënave Personale

Të dhënat personale përpunohen nga Savatours për mundësinë e orimit të shërbimit ndaj klientit. Për këtë arsye të dhënat tuaja për të komunikuar të dhënat e domosdoshme për të mundësuar udhëtimin dhe rezervimin pranë hoteleve/njësive të ofrimit të shërbimeve turistike, për të plotësuar faturat për shërbimet turistike që klientët tanë zgjedhin, për t’ju përgjigjur kërkesës tuaj për shërbim ose ndihmë, për të krijuar dhe përmirësuar shërbimet turistike për klientet tane, si edhe për të zbatuar çdo detyrim që ligji ne fuqi mund t’i ngarkojë Savatours.

Përhapja e të Dhënave Personale

1. Me pëlqimin e Klientit dhe përmbushjen e kontratës me klientin

Savatours nuk do t’i transmetojë të dhënat tuaja personale palëve të treta, me përjashtim të rasteve kur është dhënë pëlqimi juaj shprehimisht për një gjë të tillë dhe vetëm për përmbushjen e kontratave ndërmjet Savatours dhe klientit. Përhapja e të dhënave personale të të tretët do të bëhet vetëm nëse këto palë janë agjentë apo janë shërbim të Savatours dhe veprojnë në përputhje me udhëzimet tona dhe legjislacionin në fuqi për trajtimin e të dhënave personale.

2. Në zbatim të detyrimeve ligjore dhe në mbrojtje të të drejtave të ligjshme

Savatours do të beje të ditura të dhenat tuaja personale sa here që Savatours-it i kërkohet nga, gjykata, prokuroria, apo çdo instancë tjetër shtetërore dhe është e detyrueshme për Savatours nga ligjet në fuqi, apo për të mbrojtur klientet tane nga praktikatat mashtruese dhe të jashtelidhshme.

Ruajtja dhe Siguria e të Dhënave tuaja

Savatours përdor teknologjinë me bashkëkohore për të ruajtur dhe siguruar në mënyrë elektronike dhe fizike të dhënat tuaja personale, si dhe për të ndaluar aksesin e paautorizuar në sistemet e komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave.

Procedurat e Savatours i mundësojnë kontaktin me të dhenat personale vetëm atyre që e kanë të nevojshme dhe të domosdoshme këtë kontakt në bazë të ligjit. Gjithashtu Savatours detyron

kedo qe bie ne kontakt me keto te dhena qe t'i ruaje ato me mirebesim dhe ne zbatim te legjislacionit ne fuqi. Të autorizuarit dhe punonjësit e Savatours janë të detyruar të ruajnë e të mbrojnë të dhënat dhe fshehtësinë e komunikimeve, që kryhen nëpërmjet rrjetit e shërbimeve të Savatours gjatë gjithë periudhës së kryerjes së veprimtarisë, por dhe pas përfundimit të saj Savatours i ruan te dhenat tuaja vetem per aq kohe sa kerkohet apo lejohet nga legjislacioni ne fuqi. Te dhenat personale nuk mbahen me gjate se sa nevojitet per te arritur qellimet per te cilat keto te dhena perpunohen (ofrimi i shërbimit).

Savatours perdor teknologjine me bashkekohore per shkaterrimin e çdo informacioni ne lidhje me te dhenat personale, kur kjo kerkohet.

Ne çdo rast, Savatours informon menjehere ne rast se dyshon apo njoftohet se eshte rrezikuar siguria e te dhenave personale.

Të dhënat e mbledhura nga Savatours vetëm për qëllime rezervimi dhe të lëna me vullnet të lirë nga subjekti i të dhënave mund të transferohen ose të ruhen në një vend jashtë Zonës Ekonomike Europiane. Gjithashtu, të dhënat mund të përpunohen nga stafi i hotelierisë ose mjeteve të transportit për të bërë të mundur udhëtimin dhe qëndrimin e klientit.

Të dhënat e mbledhura nga Savatours mund të përdoren për të informuar klientët mbi ofertat e ndryshme të agjencisë.

Klienti ka të drejtë të kërkojë nga agjencia të njihet me informacionin që mund të jëtë mbledhur për të dhe më pas të mos përpunojë të dhënat personale me anë të e-mail ose një kërkesë drejtuar Savatours në adresën e kontaktit.

Aksesi dhe kërkesa për Korrigjim dhe Fshirje

1. Aksesi ne te dhenat tuaja

Në zbatim të nenit 12 të Ligjit 9887, ju keni të drejtën të kërkonit informacion mbi të dhënat tuaja personale që përpunohen nga Savatours Kërkesa nevojitet të dërgohet me shkrim në adresën: Rruga "Brigada e 8-te" Nr.2 Pallatet "Pinguli", Tiranë, Shqipëri

Ju mund te keni akses ne te dhenat tuaja duke kontaktuar personin e kontaktit të indikuar në fund të këtyre Politikave. Savatours ka detyrimin ligjor dhe do t'ju përgjigjet brenda një afati 30 ditor nga data e marrjes së kërkesës.

2. Korrigjimi dhe fshirja

Në zbatim të nenit 13 të Ligjit 9887, ju keni të drejtën për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vini re se të dhënat tuaja nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e ligjit.

Savatours, ka detyrimin ligjor dhe do t'ju përgjigjet brenda një afati 30 ditor nga data e marrjes së kërkesës për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e korrigjimit apo të fshirjes.

E drejta për të kundërshtuar, ankuar dhe kompensimi i dëmit

Në zbatim të nenit 15 të Ligjit 9887, ju keni të drejtën për të kundërshtuar, në çdo kohë, përpunimin e të dhënave rreth jush, sipas shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 6 të Ligjit 9887, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj; keni të drejtë pa pagesë t'i kërkonit Savatours të mos fillojë ose, nëse përpunimi ka filluar, të ndalojë përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë si dhe të informohet përpara përhapjes për herë të parë të të dhënave personale për këtë qëllim.

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit 9887, ju keni të drejtën për t'u ankuar në rast se pretendoni se u janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, si të ankohet ose të njoftojë komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, ju mund të ankoheni në gjykatë. Në rast se klienti ka bërë ankim, Savatours nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Në zbatim të nenit 17 të Ligjit 9887, ju keni të drejtën që në rast se iu është shkaktuar dëm si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, keni të drejtë të kërkoni kompensim, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Civil.

KONTAKT

Per gjithçka ne lidhje me te dhenat personale ju mund te kontaktoni ne kontaktin e meposhtem:

Oficeri i Privatësisë Savatours Sh.p.k.

Zj. Vojsava Bardhi, Rruga "Brigada e 8-te" Nr.2 Pallatet "Pinguli", Tiranë, Shqipëri